Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

RAPORTI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Eksperti Shqyrtues	Data e autorizimit të ekspertit	Date e dorëzimit të raportit	Nr. i lëndës
Florije Rexhepi	**13.12.2023**	**26.12.2023**	**2023/0996**

BAZA LIGJORE E SHQYRTIMIT

Me datën: 11.12.2023, OE "FOLEJA MOTORS L.L.C."- Prishtinë, ka parashtruar ankesë me nr: 2023/0996, kundër njoftimit për dhënie të kontratës, lidhur me aktivitetin e prokurimit: "Furnizim me vetura per institucionet e Republikes se Kosoves" me nr. të prokurimit: "UA/2016-23-5626-1-1-1", iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Agjencia Qendrore e Prokruimit .

Ankesa është e përsëritur, Vendimi i OSHP-se, Nr. 670/23.

Konform nenit 113, 114 të Ligjit Nr. 04 / L - 042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04 / L - 237, Ligjin 05 / L - 068, dhe Ligjin 05 / L - 092, Eksperti Shqyrtues i ka shqyrtuar pretendimet ankimore të OE ankues.

DISPOZITAT E SHKELURA DHE PRETENDIMET ANKIMORE

Ligji Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik në Republikën e Kosovës (këtu e tutje "LPP");

Ligji Nr. 04/L -237 për ndryshmin dhe plotësimin e Ligji Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik në Republikën e Kosovës (këtu e tutje "LPP I");

Ligji Nr. 05/L-068 për ndryshmin dhe plotësimin e Ligji Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik në Republikën e Kosovës (këtu e tutje "LPP II");

Ligji Nr. 05/L-092 për ndryshmin dhe plotësimin e Ligji Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik në Republikën e Kosovës (këtu e tutje "LPP III");

Ligji Nr. 05/L -031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative (këtu e tutje "LPPA"); - Rregullore Nr. 001/2022 për Prokurimin Publik (këtu e tutje "Rregullorja").

KRITERET PËR VLERËSIM

Certifikata e biznesit.

RAPORTI I KOMISIONI VLERËSUES

Duke u bazuar në raportin e vlerësimit, komisioni vlerësues ka konstatuar si në vijim:

OE ankues eshte i papergjegjshem

OE i rekomanduar për kontrate eshte i pergjegjshem

INFORMACIONET SHTESË TË MARRA ME ANË TË SQARIME TË KËRKUARA NGA EKSPERTI SHQYRTUES/TEKNIK

N/A

VLERËSIMI SIPAS NENIT 4.1.26 TË LPP

VENDIMET E MËPARSHME TË OSHP LIDHUR ME RASTET E NGJASHME

Vendimi i OSHP-se, Nr. 670/23.

ARSYETIMI PËR DEVIJIM NGA PRAKTIKA E MËPARSHME

N/A

PËRGJIGJE NË PRETENDIMET ANKIMORE TË OE ANKUES - **FOLEJA MOTORS L.L.C.**

Pretendimi nr.1

Eksperti shqyrtues, sqaron se AK-ja, pas pranimit të vendimit të OSHP-se, Nr. 670/23, konform vendimit e ka kthyer ne rivlerësim aktivitetin e prokurimit dhe me datën: 13.11.2023 i është drejtuar me shkrim ARBK-se, me qellim të sqarimit të ndërrimit të certifikatës se OE ankues.

Kërkesa e AK-se, drejtuar ARBK-se:

Në emër të Agjencia Qendrore e Prokurimit – Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve kërkojmë interpretim nga ana juaj lidhur me çështjen e një Biznesi që ka ndryshuar emrin në ARBK dhe ka vazhduar shfrytëzimin e Emrit të vjetër pra Certifikatës së vjetër të Biznesit.

Kërkesa jonë drejtuar juve është se a ka të drejt një Biznes pasi që të ndryshoj Certifikatën e Biznesit në ARBK të vazhdoj të shfrytëzoj Certifikatën e vjetër për të fituar kontrata, pra të fitoj kontrata (të zhvilloj biznes) me emrin e vjetër, vulën e vjetër dhe çdo dokument tjetër dhe duke mos përmendur emrin e ri askund. Certifikata e re siç shihet më poshtë është e lëshuar me datën 23.05.2023 ndërsa tek ne ky Biznes ka dorëzuar certifikatën e vjetër me datën 25.07.2023 (dy muaj pas ndryshimit të certifikatës) si dhe çdo dokument e ka të nënshkruar dhe **Vulosur me emrin dhe vulën e vjetër. Andaj a ka pasur të drejt ky biznes të vazhdoj të shfrytëzoj certifikatën e vjetër të biznesit pas datës kur i është lëshuar certifikata e re, a është i obliguar që nga data e pranimit të certifikatës së re të vazhdoj operimin me atë certifikatë apo mundet të mos e paraqes certifikatën e re fare.**

Më poshtë po ju sqarojmë të gjithë situatën duke ju bashkangjitur dëshmitë që kemi dhe kërkojmë nga ju mundësisht të na ofroni këtë përgjigje sa me parë që të keni mundësi pasi që jemi në një situatë ku janë shkaktuar vonesa të shumta dhe nuk kemi zgjidhje tjetër përveç që të presim interpretimin nga ana juaj.

Auto Shtëpia Siqani SH.P.K.

Emri biznesit / Naziv biznisa / Name of business

Auto Shtëpia „Siqani"

Emri tregtar / Trgovačko Ime / Commercial name

Lloji biznesit:	Shoqëri me përgjegjësi të kufizuara
Poslovni tip:	Društvo sa ograničenom odgovornošću
Business type:	Limited Liabilities Companies
Adresa:	Magj.Prishtinë-Shkup Km 8, pn
Adresa:	Llapllasellë
Address:	Graçanicë
Data e regjistrimit:	
Datum registracije:	31/12/2020
Date of registration:	

05/02/2021

Data / Date / Datum

Nënshkrimi / Signature / Potpis

Kjo është Certifikata e Biznesit e dorëzuar nga OE: Auto Shtëpia Siqani SH.P.K., Prishtine, 10000, me datën 25.07.2023 në ofertën e tij.

Gjate vlerësimit të ofertave Komisioni i Vlerësimit ka vërejtur që ky emër i biznesit nuk figuron në ARBK, ndërsa me këtë numër te biznesit figuron një Biznes me emër tjetër. Pra nuk ka pasur asnjë informim nga Biznesi në fjalë për këto ndryshime dhe çdo dokument ka qenë me emrin e "Auto Shtëpia Siqani".

Me datën: 16.11.2023, Agjensioni për Regjistrimin e Bizneseve të Kosovës, në përgjigje deklaron si më poshtë:

Referuar kërkesës tuaj me Nr.226/23 të datës 13.11.2023, të pranuar në MINT/ARBK, në vijim gjeni përgjigjen e ARBK-së.

Në bazë të regjistrit zyrtar të ARBK-së, Shoqëria Tregtare AUTO SHTËPIA "SIQANI"sh.p.k –Prishtinë me NUI:811493155, është regjistruar me datë 31.12.2020.

Me datë 23.05.2023 Shoqëria Tregtare AUTO SHTËPIA "SIQANI"sh.p.k –Prishtinë, ka aplikuar për ndryshim të emrit ku nga emri i Shoqërisë Tregtare "AUTO SHTËPIA "SIQANI"sh.p.k, ka regjistruar emrin e ri të Shoqërisë Tregtare me emrin "FOLEJA MOTORS"L.L.C me NUI:811493155.

Pra, aktualisht Shoqëria Tregtare në fjalë është e regjistruar me emrin "FOLEJA MOTORS"L.L.C.

Vlen të theksohet që përfaqësuesit e autorizuar të Shoqërisë Tregtare, kanë dorëzuar në ARBK certifikatën origjinale të biznesit me emrin AUTO SHTËPIA "SIQANI"sh.p.k si dhe kanë përfunduar të gjitha procedurat ligjore për ndryshimin e emrit të biznesit.

Kësaj përgjigje i bashkangjitet edhe dokumenti me historinë e biznesit në fjalë.

Ju faleminderit për bashkpunimin tuaj!

Pas pranimit të përgjigjes së dhënë më lart, autoriteti kontraktues, e eliminon OE ankues me arsyetimin se:

Oferta e juaj është vlerësuar si oferte e papërgjegjshme pasi që keni dorëzuar ofertë me emrin e vjetër edhe pse ndryshimi në ARBK është bërë me datën 23.05.2023 ndërsa ofertimi është bërë me datën 25.07.2023.
Bazuar në vendimin e OSHP-së me nr. 2023/0670 kemi kërkuar interpretim nga KRPP të cilët kanë refuzuar të interpretojnë këtë çështje, gjithashtu kemi kërkuar interpretim nga MTI/ ARBK të cilët kanë deklaruar: "Vlen të theksohet që përfaqësuesit e autorizuar të Shoqërisë Tregtare, kanë dorëzuar në ARBK certifikatën origjinale të biznesit me emrin AUTO SHTËPIA "SIQANI" sh.p.k si dhe kanë përfunduar të gjitha procedurat ligjore për ndryshimin e emrit të biznesit." Me këtë rast mund të konsiderohet si tentim për mashtrim nga ju pasi që në ofertën e tuaj keni ngarkuar certifikatën e biznesit që tashmë nuk e kishit origjinalin por keni dorëzuar vetëm kopje të atij dokumenti si dhe keni dorëzuar sigurim të tenderit, deklaratën nën betim, deklaratën për specifikacion teknik, deklaratën për liferim, deklaratën për garancion, autorizimin dhe çdo dokument tjetër në emrin e vjetër edhe pse tashmë në kohën kur është bërë dorëzimi i ofertave (për më tepër 2 muaj më herët) kishit ndryshuar emrin e biznesit. Duke pasur parasysh që kjo është ndoshta një tentim për mashtrim apo ndoshta një gabim i juaj konsiderojmë që përgjegjësia dhe pasojat duhet ti bartë ju duke u eliminuar nga ky aktivitet i prokurimit.

I pakënaqur me vendimin e AK-së, OE ankues ka parashtruar ankese me pretendimin se AK-ja, nuk i ka respektuar dispozitat e LPP-së, kryesisht nuk është respektuar vendimi i PSH-së, me arsyetimin se është vërtetuar fakti që OE ankues e ka pasur të pamundur të bëje ndryshimin e emrit në sistemin e E-Prokurimit, përderisa këtë nuk e kishte realizuar edhe pran ATK-se, sepse sipas OE ankues e gjithë kjo procedurë ka zgjatur në ATK.

Eksperti shqyrtues, sa i përket kësaj çështje ka dhënë vlerësimin ne raportin me nr. 670/23, në të cilin ka konstatuar se OE ankues nuk i ka respektuar dispozitat e nenit 3.16 të Rregullores për Prokurim Publik Nr. 001/2022.

Eksperti shqyrtues, bazuar edhe në sqarimin e ARBK-së, sqaron se OE ankues e ka dorëzuar certifikatën e vjetër dhe është pajisur me certifikatë të re me datën: 23.05.2023 me emrin Foleja Motors LLC, që do të thotë se OE ankues në ditën e dorëzimit të ofertave (25.07.2023) nuk e ka pasur aktive certifikatën me emrin Auto Shtëpia Siqani me të cilin edhe ka aplikuar në këtë aktivitet të prokurimit.

REKOMANDIMI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues refuzohet si e pabazuar dhe të mbetet në fuqi vendimi i AK.

Raporti i ekspertizës ti dorëzohet:

- Autoritetit Kontraktues – **Agjencia Qendrore e Prokruimit**
- Panelit Shqyrtues – OSHP
- OE ankues – **FOLEJA MOTORS L.L.C.**

REPUBLIKA E KOSOVËS ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI PRISHTINË/A REPUBLIKA KOSOVA

Florije Rexhepi